



DEKLARATË PRIVATËSIE

LIDHUR ME PËRPUNIMIN E TË DHËNAVË PERSONALE TË VIZITORËVE NË OBJEKTIN E PARABURGIMIT

Përmbajtja

DEKLARATË PRIVATËSIE	1
1. HYRJE.....	1
2. QËLLIMI I PËRPUNIMIT TË TË DHËNAVE	1
3. TË DHËNAT QË PËRPUNOHEN.....	2
4. AUTORITETI PËRGJEGJËS PËR PROCESIN E PËRPUNIMIT	3
5. MARRËSIT E TË DHËNAVE	3
6. DISPONUESHMËRIA E TË DHËNAVE, QASJA NË TO DHE KORRIGJIMI I TYRE	3
7. ARSYEJA PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE	3
8. PERIUDHA E MBAJTJES SË TË DHËNAVE	3
9. KONTAKT	4
10. ANKESAT.....	4

1. HYRJE

Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) u përmbahen standardeve më të larta në mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave personale. Në pajtim me nenin 34(11) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, punonjësi për mbrojtjen e të dhënave i DHSK-së udhëhiqet nga standardet e BE-së për mbrojtjen e të dhënave personale. Kjo deklaratë për privatësinë ju tregon se çfarë mund të prisni kur DHSK-ja mbledh të dhëna dhe vlen për të dhënat që ne mbledhim për vizitorët që janë anëtarë të familjes dhe vizitorë të tjerë personalë në objektin e paraburgimit që ndodhet në burgun holandez PI Haaglanden, ose për vizitat përmes videolidhjes.

2. QËLLIMI I PËRPUNIMIT TË TË DHËNAVE

Qëllimi është që të administrohet procesi i miratimit të lejes për vizitë, proces që drejtohet prej Njesisë së Paraburgimit. Prosesi i administrimit përfshin identifikimin e vizitorit dhe verifikimin e informacionit të dhënë nga vizitori, vlerësimin e qëllimit të vizitës dhe, në rast të miratimit, konfirmimin e datës dhe kohëzgjatjes së vizitës së propozuar. Edhe formalitetet për sigurimin e vizës mund të lehtësohen mbi

bazën e informacionit të dhënë nga vizitori. Për ruajtjen e sigurisë, veprimet e vizitorëve gjatë vizitës së tyre në objektin e paraburgimit mbikëqyren prej kamerave të sigurisë.

3. TË DHËNAT QË PËRPUNOHEN

Përdoren vetëm të dhënat e nevojshme për përmbushjen e qëllimeve të lartpërmendura. Të dhënat personale që mund të përpunohen për qëllimet e lartpërmendura janë:

- emri i të paraburgosurit
- data dhe kohëzgjatja e vizitës së propozuar
- të dhëna të vizitorit:
 - data dhe vendi i lindjes;
 - të dhëna të pasaportës;
 - të dhëna të kontaktit (adresa, numra telefoni, e-mail).
- Të dhëna të përgjithshme:
 - karrierë qeveritare ose në shërbimin civil;
 - dëshmi penaliteti;
 - historia si dëshmitar;
 - angazhimi në media.
- Marrëdhënia me të paraburgosurin:
 - anëtar i familjes ose marrëdhënie tjetër.
- Dokumente vërtetuese:
 - faqja e pasaportës me fotografi;
 - certifikatë e martesës ose dokumentet ligjërisht i barasvlershëm, ose dokumentacion i statusit të partneritetit dhe/ose marrëdhënies prindërore;
 - certifikatë e lindjes.

Formalitetet për marrjen e vizës (nëse është relevante):

- Itinerari i udhëtimit, përfshirë detajet e fluturimit;
 - Vërtetimi i mjeteve financiare;
 - Vërtetimi i sigurimit të udhëtimit;
 - Vendi ku do të lëshohet viza juaj për Holandën.
- Nënshkrim/deklarim.

Vizitorët e lejuar do të mbikëqyren me kamera të sigurisë brenda perimetrit të objektit të paraburgimit.

Për të mbrojtur sigurinë e të dhënave personale dhe për të parandaluar qasjen, ndryshimin, fshirjen dhe nxjerrjen e paautorizuar të të dhënave, zbatohen masa të përshtatshme organizative dhe teknike.

4. AUTORITETI PËRGJEGJËS PËR PROCESIN E PËRPUNIMIT

Autoriteti përgjegjës që përcakton qëllimin dhe mjetet e procesit të përpunimit të të dhënave është DHSK-ja. Vizitorët në objektin e paraburgimit do të mbikëqyren prej kamerave të sigurisë të cilat janë në përdorim të përbashkët me shërbimin holandez të burgjeve (<https://www.dji.nl/english/>)

5. MARRËSIT E TË DHËNAVE

Të dhënat tuaja mund t'i marrin:

- anëtarë të caktuar të personelit të Njesisë së Paraburgimit dhe shefi i Seksionit të Shërbimeve Gjyqësore;
- anëtarë të caktuar të personelit të Njesisë së Sigurisë;
- personel i autorizuar i kabinetit të Administratores dhe zyrtarë të lartë;
- autoritetet e shtetit pritës;
- shërbimi i videolidhjes për takime;
- auditues të brendshëm dhe të jashtëm.

6. DISPONUESHMËRIA E TË DHËNAVE, QASJA NË TO DHE KORRIGJIMI I TYRE

Ju mund të kërkonti qasje në të dhënat tuaja personale dhe mund të kërkonti që të korrigjohen të dhënat e pasakta ose paplota; ju mund të kërkonti fshirjen e të dhënave tuaja personale nëse DHSK-ja nuk ka arsye për mbajtjen e tyre.

7. ARSYEJA PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE

Përpunimi i të dhënave tuaja, duke përfshirë kategorinë e posaçme të të dhënave personale, është i domosdoshëm për kryerjen e një detyre që është në interes publik ose gjatë ushtrimit të kompetencave zyrtare që i janë dhënë autoritetit përgjegjës; dhe në pajtim me detyrimin ligjor të autoritetit përgjegjës (Rregullorja e Paraburgimit dhe Udhëzuesi i Punës për Vizitat dhe Komunikimet miratuar në bazë të rregullës 63 të Rregullores së Paraburgimit).

8. PERIUDHA E MBAJTJES SË TË DHËNAVE

Të dhënat personale që kanë të bëjnë me administrimin e procesit të vizitave për të paraburgosurit janë pjesë e dosjes zyrtare të mbështetjes gjyqësore dhe mund të mbahen përgjithmonë për qëllime arkivimi dhe historike.

9. KONTAKT

Nëse keni pyetje në lidhje me përpunimin e të dhënave tuaja personale, ju lutemi kontaktoni punonjësin për mbrojtjen e të dhënave në dataprotection@scp-ks.org.

10. ANKESAT

Pas marrjes së përgjigjes nga Zyrtari për Mbrojtjen e të Dhënave, ju keni të drejtë ankese në çdo kohë dhe mund të kontaktoni LegalCounsel@scp-ks.org brenda kabinetit të Administratores.